VENDIM
Nr. 337, datë 26.4.2013

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 515, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE, TË MËNYRËS DHE KOHËS SË USHTRIMIT NGA ALUIZNI TË PËRGJEGJËSIVE TË ZYRAVE TË URBANISTIKËS DHE TË KËSHILLIT TË QARQEVE, GJATË PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE INFORMALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr. 515, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1 Në rastin kur njësia e qeverisjes vendore kërkon të kryejë veprimet sipas pikave 1, 3, 3.1 dhe 3.2 të këtij vendimi, ajo i drejtohet drejtorisë përkatëse të ALUIZNI-t, me kërkesë dhe argumentim se disponon kapacitetet teknike për këto veprime. Drejtoria përkatëse e ALUIZNI-t, kur vlerëson se njësia përkatëse i ka kapacitetet teknike, ia përcjell dokumentacionin që disponon njësisë së qeverisjes vendore kërkuese, me qëllim vazhdimin e procedurës sipas kërkesave ligjore.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha